

## Efekte të padëshirueshme

Pas vaksinimit, në vendin e shpimit mund të shfaqet një përskuqje me dhimbje, ndërsa sipas rastit edhe dhimbje koke e temperaturë. Pasoja të rënda të qëndrueshme nuk janë vënë re.

## Ku mund të vaksinoheni?

Për organizimin e programit të vaksinimit kundër kancerit në qafën e mitrës janë të autorizuara kantonet. Mjekja ose mjeku juaj familjar di se ç'duhet bërë.



Unë nuk dua te sëmurem nga kanceri në qafën e mitrës, pra do të vaksinohem. Me këtë rast edhe do të kontrollohem nëse kam nevojë edhe për vaksinime të tjera të rekomanduara.

Pas vaksinimit mund të paraqiten pjesërisht përskuqje dhe dhimbje ose dhe temperaturë. Mirëpo këto efekte anësore së shpejti do të zhduken sërisht. Një gjë është e sigurt: rreziku i vaksinimit është shumë më i ulët se sa ai i sëmurjes nga kanceri!



## Informacione plotësuese:

Informacione të tjera lidhur me vaksinimin do të gjeni në faqet vijuese të internetit:

[www.bag.admin.ch](http://www.bag.admin.ch)

[www.infovac.ch](http://www.infovac.ch)

[www.sichimpfen.ch](http://www.sichimpfen.ch)

[www.tschau.ch](http://www.tschau.ch)

### Publication details

© Federal Office of Public Health (FOPH)  
Edited by: Federal Office of Public Health (FOPH)  
Date of publication: July 2008

This publication is also available in German, French and Italian.

Source of supply: BBL, Verkauf Bundespublikationen, 3003 Bern  
[www.bundespublikationen.admin.ch](http://www.bundespublikationen.admin.ch)

BBL-Article number: 311.360.alb  
BAG publication number: BAG OeG 60'000 d 30'000 f 10'000 i 20EXT0805  
BAG publication number: BAG OeG 15'000 eng 15'000 esp 15'000 por 15'000 tur 15'000 skb 15'000 alb 20EXT0814

Printed on chlorine-free paper.

# Vaksinimi kundër kancerit në qafën e mitrës

## Për të gjitha vajzat e reja!



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Home Affairs FDHA  
Federal Office of Public Health FOPH

## Fakte me rëndësi

- Kanceri në qafën e mitrës shkaktohet nga virusi HPV (human papiloma virus).
- Në 100 veta infektohen me këtë virus herëdoherë gjatë jetës së tyre 70 syresh.
- Çdo e pesta femër e infektuar me ndonjë tip prej këtyre viruseve, sëmuret nga parakanceri ose nga kanceri.
- Vaksinimi ofron mbrojtje të efektshme kundër një numri të madh të këtyre sëmundjeve kanceroze.
- Vaksinimi rekomandohet për vajzat 11 vjeçe e sipër.
- Vaksinimi realizohet përmes një gjilpëre në krah, ndërsa për t'u bërë plotësisht e efektshme, duhet përsëritur dy herë.
- Shpenzimet e vaksinimit për vajza barten prej sigurimit shëndetësor.



## Arsye të mira për vaksinim

Ekzistojnë mbi 100 viruse të ndryshme të llojit papilloma. Ato sulmojnë lëkurën dhe organet gjenitale. Viruset transmetohen shumë lehtë gjatë marrëdhënieve seksuale, pa u diktuar fare. Tipa të caktuar të këtyre viruseve shkaktojnë kancerin në qafën e mitrës.

Kanceri në qafën e mitrës është një sëmundje që zhvillohet ngadalë dhe që për një kohë të gjatë kalon pa simptoma. Falë vizitave të rregullta kontrolluese tek gjinekologjia ose gjinekologu kanceri mund të zbulohet dhe të kurohet qysh në një stad të hershëm. Kurimi, ndërkaq, nuk kalon gjithnjë pa rreziqe. Vaksinimi ofron mbrojtjen efektive dhe të sigurt kundër shumicës së viruseve që shkaktojnë kancerin në qafën e mitrës.

Me gjithë vaksinimin, vizitat e rregullta kontrolluese tek gjinekologjia ose gjinekologu janë të pazëvendësueshme, ngaqë vaksinimi nuk të mbron prej të gjitha viruseve papilloma që shkaktojnë kancerin.

Prezervativët janë të domosdoshëm për t'u mbrojtur nga infeksione të transmetueshme seksualisht, si Aidsi, mirëpo ata mbrojnë vetëm pjesërisht nga viruset papilloma.

Vaksinimi përbëhet prej tri dozash, të cilat duhen marrë në një hark kohor prej gjashtë muajsh. Për një mbrojtje optimale mund të flitet atëherë kur vaksinimi realizohet akoma pa pasur rrezik infeksioni, domethënë, para marrëdhënieve të parë seksuale.

Vaksinimi u rekomandohet vajzave midis 11- dhe 14-vjeçare. Ai mund të jetë i dobishëm edhe për shumicën e femrave 15- deri 19-vjeçare.

Tek femrat mbi 20-vjeçe çështja nëse një vaksinim do të ishte i arsyeshëm duhet sqaruar individualisht, më së miri në këshillim me mjekun ose mjekun tuaj.

## Po si qëndron puna me djemtë?

Vaksinimi nuk rekomandohet për meshkujt, ndonëse këta të fundit infektohen po aq shpesh me viruset papilloma të cilët ua transmetojnë më tej partnerëve të tyre. Dobia e vaksinimit tek meshkujt nuk është provuar.

